

Raporti i Konferencës:
Profilët Socio-Ekonomike të Komunave të Rajonit të Mitrovicës
Mitrovicë, 1 korrik 2019

Ky botim është pjesë e programit të Konzortiumit të OJQ-ve (ATRC, KIPRED, BIRN, SPRC, KCBS dhe D+) “Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizëm”.

Consortium: "With Participatory Democracy for a Kosovo without Radicalization" | Konzorciumi: "Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizëm"



Përgatitur nga: Lulzim Peci, Mentor Agani, Diedon Nixha dhe Valdrin Ukshini.

Copyright © 2019, KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rrikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme dhe me çfarëdo qoftë pajisjesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo të tjera, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi. Luteni të kontaktoni: info@kipred.org apo: +381 38 542 778.

Botuar nga:



Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

Rr. Major Mehmet Bushi, H.III. No.1

10 000 Prishtinë, Kosovë

Telefoni dhe faksi: +381 38 542 778

HJRJE

Më 1 korrik 2019, në Mitrovicë u mbajt Konferenca Rajonale në temën "Profili Socio-Ekonomik i Komunave të Rajonit të Mitrovicës," e organizuar nga Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) me përfaqësues të Policisë së Kosovës, udhëheqësive dhe asambleve komunale të komunave këtij rajoni. Në këtë konferencë u prezentuan dhe u diskutuan gjetjet e punimit të KIPRED-it "Profilet Socio-Ekonomike të Komunave të Rajonit të Mitrovicës"¹, që kishte për qëllim të përdoret si nxitje për hapjen e debatit publik, si dhe që t'i ndihmojë vendim-marrësit komunalë dhe kombëtarë në formulimin dhe zbatimin e politikave që do t'i adresojnë nevojat e popullatës rinore, më në veçanti të grup-moshës 15-29 vjet. Nga gjetjet e punimit dhe diskutimet e Konferencës janë identifikuar çështjet në vijim që kërkojnë trajtim urgjent nga autoritetet komunale dhe nacionale:

- a) Komuna e Mitrovicës duhet ta rrisë substancialisht buxhetin për aktivitete rinore, sportive dhe kulturore, për t'i plotësuar nevojat bazike të rinisë në këto fusha.
- b) Komuna e Mitrovicës, dhe Këshilli i Bashkësisë Islame në këtë komunë, duhet të kenë kujdes të madh lidhur me ndërtimin e xhamive të reja, dhe para së gjithash duke pasur parasysh origjinën e donacioneve për ndërtimin e tyre, nevojat e komunitetit dhe planin urbanistik.
- c) Në Komunën e Vushtrisë duhet të rritet numri i policëve dhe dislokimi i tyre gjeografik në aspektin urban/rural për shkak të nivelit të lartë të kriminalitetit në këtë komunë.
- d) Komuna e Skenderajt duhet ta rrisë buxhetin për aktivitete rinore, sportive dhe kulturore për të adresuar nevojat bazike të rinisë në këto fusha,

¹ Profilet Socio-Ekonomike të Komunave të Rajonit të Mitrovicës, KIPRED, qershor 2019.

- e) Qeveria e Kosovës duhet t'i mbulojë në tërësi shpenzimet për aktivitetet vjetore të manifestimeve të 5 – 8 marsit, për të evituar ngarkesat buxhetore për Komunën e Skenderajt në fushën e kulturës, rinisë dhe të sporteve.
- f) Qeveria e Kosovës, autoritetet komunale dhe shoqëria civile duhet t'i kushtojnë kujdes dukurisë së mosvotimit në zgjedhjet nacionale dhe komunale të personave me bindje radikale fetare, të cilët kanë lojalitet të plotë ndaj Ligjit të Sheriatit dhe e refuzojnë sistemin juridik dhe kushtetues të Kosovës.

Për të pasur një ndërlidhje sa më të mirë midis punimit prezantuar dhe diskutimeve në konferencë, ato do t'i përmbledhim sipas komunave përkatëse të rajonit të Mitrovicës.

Komuna e Mitrovicës

Pas pjesës hyrëse të Konferencës, ku u bë prezantimi i punimit të Profilit të Rajonit të Mitrovicës nga ana e KIPRED-it, fjalën e mori Nënkoloneli Nysret Mehmeti, Zëvendës Drejtor Rajonal në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Mitrovicë. Ai foli për çështjet lidhur me sigurinë në këtë Rajon, si dhe për punën e Policisë së Kosovës lidhur me këto çështje.

Në fjalën e tij, Nënkolonel Mehmenti theksoi që Policia i ka dy strategji të vetat që ndërlidhen me çështjet e diskutuara në Profilin e prezantuar. Ai u përqendrua në strategjinë e Policisë në Bashkësi, e cila ka shkuar në dy faza, ku e para ka qenë nga viti 2012, dhe ajo e fundit nga viti 2017 dhe do të zhvillohet deri më 2021. Në kuadrin e kësaj strategjie, përmendi ai, sektorët janë të ndarë, dhe janë disa nënobjektiva, ku më të rëndësishmit janë sigurimi i informatave të hershme për personat që mund të përfshihen në ekstremizëm, si dhe raportimi mujor, i cili i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës.

Lidhur me veprat penale në rajonin e Mitrovicës, Nënkolonel Mehmeti e theksoi si problem të veçantë gjendjen e rëndë ekonomike në rajon, e cila e rrit numrin e veprave penale. Përndryshe, ai e përmendi edhe Raportin Periodik për Rajonin e Mitrovicës, i cili e vë në dukje që, falë punës së Policisë, në këtë rajon gjatë vitit 2018 kanë qenë 184 raste të veprave penale më pak se në vitin 2017, gjë kjo që e paraqet një rënie për -6.4%.

Pas tij, fjalën e mori Vesel Neziri, anëtar i Kuvendit Komunal në Mitrovicë nga Partia e Drejtësisë. Ai në fillim u përqendrua në çështjen që në Kosovë feja nuk financohet nga shteti. Meqë shteti i Kosovës nuk i paguan imamët, tha ai, ata paguhën nga organizatat e jashtme, nga Jemeni, Siria, Iraku, Irani, dhe me këto pagesa, sipas Nezirit, këto organizata të jashtme imamët i bëjnë për vete. Imamit, siç tha ai, këto organizata ia

ndërtojnë xhaminë, ia bëjnë shtëpinë në oborrin e xhamisë, dhe, më pas, i thonë t'u tregojë besimtarëve se cilat janë ritet dhe traditat tona fetare në Kosovë. Lidhur me këtë, Neziri theksoi atë që Qeveria e Kosovës i paguan priftërinjtë ortodoksë për mësimin fetar që e mbajnë në Republikën e Kosovës, dhe, duke e ndërlidhur këtë me faktin që imamët nuk paguhen nga shteti, e nxori përfundimin që imamët nuk janë në pozita të barabarta me priftërinjtë. Duke e komentuar këtë, Neziri shtoi që askund në Evropë, në vendet që i kanë mbi 95% të popullatës së krishterë, pakicat fetare nuk kanë aq të drejta sa kanë pakicat fetare në Kosovë. Po ashtu, Neziri shtoi që organizatat fetare të jashtme në Kosovë kanë hyrë nga të gjitha anët: ai përmendi që ka organizata islamike, por ka edhe plot organizata të tjera që kanë sjellur dhe shpërndajné Bibla e revista fetare të krishtera.

Duke folur për radikalizimin islamik, Neziri e përmendi ndikimin, sipas tij, negativ të njerëzve që nuk kanë kurrfarë lidhje me fenë, por që dalin publikisht e thonë që nuk duhet të ndërtohen xhami. Lidhur me këtë ai i cekti disa tubime në Mitrovicë në të cilat protestuesit kanë kërkuar të mos ndërtohen xhamitë. Ai përmendi që, edhe pse pohohet që numri i xhamive të ndërtuara është i madh, atij vetë i ndodh shpesh herë që ritualet fetare t'i kryej në kushte të vështira, ku e përmendi posaçërisht të ftohtit gjatë dimrit kur faljet, për shkak të numrit të madh të besimtarëve duhet të bëhen jashtë xhamive. Këtu ai i përmendi demonstratat që janë bërë për të mos u ndërtuar një xhami në Mitrovicë, ku kanë qenë rreth njëzet veta, që thoshin që duhet të ndërtohet shkolla, jo xhamia. Një qasje e tillë, sipas tij, mund të çojë kah radikalizimi i mëtutjeshëm islamik. Si një ndër shkaqet e tjera që mund të çojnë në radikalizim z. Neziri e përmendi edhe nevojën për futjen e mësimin të besimit fetar nëpër shkolla: mes tjerash, ai e përmendi atë që vendet e Evropës e kanë mësimin e besimit fetar në planprogramet e shkollave të tyre, gjë kjo që në Kosovë nuk praktikohet. Sipas tij, kur diçka ndalohet, njerëzit do të ngulmojnë

pikërisht në këtë, dojnë ta thejnë tabunë, dhe kjo është një nga arsyet pse disa prej tyre bëhen ekstremistë.

Për gjendjen e vështirë në Mitrovicë asambleisti Neziri e fajësoi faktin që nga të gjitha projektet që fillohen në Mitrovicë, asnjëri nuk përfundohet. Në këtë, si dhe për gjendjen e vështirë në komunë, ai Mitrovicën e krahasoi me komunën e Gjakovës.

Në fjalën e vet, asambleisti në KK të Mitrovicës, z. Fidan Ademi, reagoi lidhur me demonstratën që në Mitrovicë ishte bërë për të mos u ndërtuar xhamia, e për të cilën paraprakisht kishte folur z. Neziri. Për numrin e xhamive në Mitrovicë z. Ademi shprehu mendimin që ky numër është i mjaftueshëm. Për më tepër, ai theksoi që shumë nga xhamitë nëpër fshatra janë të boshatisura, meqë nuk ka besimtarë që i frekuentojnë. Ai theksoi që protesta kundër ndërtimit të xhamisë ka qenë shkaku i donacionit: ky, siç theksoi, ka qenë një donacion i dyshimtë, i një biznesmeni të dyshimtë, prej një shteti të dyshimtë të Lindjes së Mesme. Kjo ka qenë arsyeja e protestës, dhe sipas z. Ademit, duhet të respektohet bindja që e ka komuniteti.

Përndryshe, duke folur për Raportin e diskutuar, z. Ademi tha se sipas mendimit të tij një mungesë e këtij Raporti është që nuk e shtron çështjen e nevojës së analizës së mënyrës si bëhet indoktrinimi i ekstremistëve. Çështja e indoktrinimit përmes rrjeteve sociale, sipas z. Ademit, pra, përmes faqeve që vazhdimisht bëjnë thirrje të tilla është një që duhet të analizohet. Është interesante, theksoi ai, të bëhet një vlerësim sa kanë ndikuar këto faqe në shkuarjen e një numri të kosovarëve në luftën në Siri.

Z. Ademi po ashtu theksoi që çështja e e zvogëlimit të popullatës që vërehet nga analizat demografike në Raport është tejet brengosëse. Lidhur me këtë ai tha që është tejet shqetësuese që në tryezë nuk kishin ardhur përfaqësuesit më të lartë të tri komunave në fjalë, të cilët ishin të ftuar. Përndryshe, lidhur me problemet e gjendjes

ekonomike të Mitrovicës, z. Ademi tha që më parë Mitrovica ka qenë një komunë tejet e industrializuar; më vonë, me shkatërrimin e industrisë, ka ardhur deri te dobësimi ekonomik i Mitrovicës dhe deri te varfërimi i saj.

Në fund, z. Ademi e hapi edhe çështjen e mospërfshirjes në këtë hulumtim të pjesës veriore të Mitrovicës. Ai theksoi që pjesa në veri është më e dhunshme dhe më ekstremja në Kosovë, dhe që Kisha Ortodokse Serbe vazhdimisht bën thirrje për gjenocid dhe për spastrim etnik të Kosovës. Në Evropë, sipas tij, nuk ka asnjë rast që ndonjë kishë lejohet të funksionojë nëse ajo bën thirrje për zhdukjen e popullatës në territorin ku ajo vepron. Përndryshe, këtë z. Ademi e ilustroi me fjalorin fashist që ishte përdorur me rastin e krenimit të Vidovdanit serb.

Lidhur me veriun e Mitrovicës dhe mospërfshirjen e saj në hulumtim, Kryesuesi i Konferencës, Drejtori Ekzekutiv i KIPRED-it, z. Lulzim Peci sqaroi që kjo është pasojë e mungesës së qasjes në Veri. Të vetmet informata që KIPRED-i ka mundur t'i sigurojë kanë qenë ato nga Policia e Kosovës. Po ashtu, z. Peci e përmendi edhe atë që komunat në veri nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullatës, kështu që nuk ka patur kurrfarë mundësie për të siguruar të dhënat demografike për to. Në fund, z. Peci theksoi që Raporti i KIPRED-it nuk ka synuar ta bëjë ndonjë vlerësim të feve, por vetëm ta paraqesë infrastrukturën fetare: pra, sa ka kisha, sa ka xhamia, e gjëra të tilla.

Lidhur me fjalën e asambleistit të KK të Mitrovicës, z. Ademit, fjalën përsëri e mori z. Vesel Neziri, anëtar i Kuvendit të Mitrovicës nga Partia e Drejtësisë. Ai e përsëriti çështjen e financimit dhe kontrollimit të BIK-ut. Sipas tij, është dashur që BIK-u pas luftës të futet nën institucionet e Kosovës dhe të paguhet nga institucionet e Kosovës, ashtu që të punojë nën mbikëqyrjen e tyre. Fatkeqësisht, sipas z. Nezirit, kjo nuk ndodhi, dhe ne tash kemi financim nga jashtë, dhe tash nga jashtë futet një frymë e re e Islamit në Kosovë, e cila nuk përputhet me Islamin tradicional.

Z. Neziri theksoi po ashtu që gjatë luftës në Kosovë ka patur përpjekje që në luftë të futet edhe feja, ashtu që lufta e Kosovës të bëhej fetare. Ai e vuri në dukje që është dashur një punë shumë e madhe që kjo të parandalohet, dhe që këtë futje të elementit fetar në luftë e ka dashur më së shumti Serbia.

Një nga çështjet që u shtrua në Konferencë ishte ajo e lidhjes midis nivelit të kriminalitetit në tri Komunat e trajtuara, dhe investimeve që bëhen në rini në ato Komuna, të dhëna këto që parashtojnë një dukuri mjaft interesante. U përmendën të dhënat e parashtruara në Profilin e Rajonit të Mitrovicës: Nivelin më të lartë të investimit në të holla në rini e ka Komuna e Vushtrrisë, 435 mijë € në vit; Komuna e Mitrovicës këto investime i ka përafërsisht katër herë më të vogla, 102 mijë € në vit (edhe pse, siç u përmend, Buxheti i Mitrovicës është më i madh se ai i Vushtrrisë), ndërkaq, Komuna e Skenderajt në rini i investon rreth 280 mijë €. Nga kjo ka mundur të pritet që kriminaliteti do të duhej të ishte më i larti në Mitrovicë (dhe, po ashtu, edhe për shkak të pozitës – meqë është Komunë kufitare mundësitë e kontrabandës janë më të mëdha në Komunën e Mitrovicës), mirëpo, në realitet, kriminaliteti, sipas Profilit, është më i larti në Vushtrri. (Për nga niveli i kriminalitetit Mitrovica është në vendin e dytë, ndërkaq, në të tretin qëndron Skenderaj.)

Pjesëmarrësit e Konferencës i dhanë disa mendime të tyre për ta interpretuar këtë dukuri. Kështu, Nexhmedin Spahiu, nga OJQ Mitrovica tha që në Mitrovicë varfëria është më e madhe, dhe, si pasojë, edhe migrimi është më i madh. Për këtë ai i përmendi edhe të dhënat e Profilit për rënien e popullatës së Mitrovicës në periudhën nga viti 2011 deri në 2018. Dhe, siç tha ai, gjatë migrameve ndodh që ikën edhe pjesa më problematike. Këtë ai e ilustroi me përvojën e tij personale: ai përmendi që në një periudhë të mëparshme zyrat e tij ishin thyer shumë shpesh, pothuaj çdo javë, por kur

ndodhi ikja e madhe, mbi 100 mijë veta, thyerja e zyrave të tij nuk u përsërit më – meqë, sipas të gjitha gjasave, kishin ikur edhe hajnat që më parë e kishin bërë thyerjen.

Në vërejtjen që iu bë, që socio-ekonomikisht në rajon më së dobëti qëndron komuna e Skenderajt, por kjo e ka edhe nivelin më të ulët të kriminalitetit, zoti Spahiu e përmendi përvojën e Shqipërisë në trazirat e 1997-tën. Në ato trazira, kur në Shqipëri kishte rënë shteti, sipas Zoti Spahiut, në Shkodër niveli i kriminalitetit kishte mbetur i njëjti, ndërkaq, në Vlorë janë vrarë rreth 2 mijë veta. Shkaktar i kësaj, sipas tij, ishte fakti që në Shkodër funksionon Kanuni, ndërkaq, në Vlorë ai nuk funksionon. Përmes këtij krahasimi, Zoti Spahiu u përpoq që shkaqet e niveleve të ndryshme të kriminalitetit në tri komunat e rajonit të Mitrovicës t'i shpjegonte përmes funksionimit të ndryshëm të Kanunit në këto tri komuna.

Lidhur me çështjen e niveleve të ndryshme të kriminalitetit foli përsëri Nënkoloneli Nysret Mehmeti nga Policia e Kosovës, Zëvendës Drejtor Rajonal i Drejtorisë Rajonale të Policisë në Mitrovicë, i cili në pjesën e fjalës së tij për Komunën e Mitrovicës tha që këtu duhet të mirret parasysh fakti që vetë rajoni i Mitrovicës është i vogël, kështu që ka lëvizje të kryerësve të veprave kriminale, gjë kjo që duhet të merret parasysh kur flitet për këtë temë. Ai theksoi që para dy vitesh gjendja në Mitrovicë ka qenë më e rëndë, por që në dy vitet e fundit kemi zbutje të gjendjes atje, dhe rritje të kriminalitetit në Vushtrri. Po ashtu, Nënkoloneli Mehmeti përmendi faktin që në nivel të vendit ka qenë problematik numri alarmant i grabitjeve. Por, në krahasim me rajonet e tjera, rajoni i Mitrovicës ka patur numër më të vogël të grabitjeve.

Në fjalët e tij për këtë çështje, Nevzat Tahiri, anëtar i Kuvendit Komunal të Mitrovicës e bëri ndërlidhjen midis nivelit të kriminalitetit në komunat e veçanta, dhe përqindjeve të buxhetit që ndahet për rini. Ai e shprehi mendimin e vet që nivelet e kriminalitetit në këto tri komuna janë shumë të ulëta krahasuar me atë sa pak jipet nga buxheti për rini.

Ai theksoi që personalisht në disa raste ka kërkuar ngritjen e subvencioneve që ndahen për rini, por ka hasur në mospërkrahje nga asambleistët e tjerë. Asambleistët, siç theksoi Zoti Tahiri, shikojnë që ta marrin ndonjë copë të buxhetit e ta shtrojnë ndonjë rrugë për lagjet ku jetojnë votuesit e tyre, dhe janë të paktë në mesin e tyre që përqendrohen në të mirën e përgjithshme, ku njëra ndër to është rinia.

Asambleist Tahiri theksoi që ai vetë me profesion është profesor i Edukatës Fizike, dhe nga përvoja e tij e di mirë që me aktivitetet rinore, sportive dhe kulturore, zvogëlohet niveli i kriminalitetit. Ai këtë e ilustroi me shifra konkrete. Në Mitrovicë, theksoi ai, janë 44 klube sportive, dhe këtu për rini, për të tre sektorët – kulturën, rininë dhe sportin – jipen gjithsej 50.000 € në vit. Me fjalë të tjera, një sektor që ka të bëjë me rininë, i merr 16.600 € në vit. Pra, sipas fjalëve të asambleistit Tahiri, për 44 klube sportive, Komuna e Mitrovicës i ndan 16.600 €. Prandaj, përfundoi Tahiri, kriminaliteti në Mitrovicë është tepër i vogël kur të merret fakti se sa pak financim bëhet për çështjet rinore.

Komuna e Vushtrrisë

Në pjesën hyrëse të fjalës së tij, Nënkolonel Nysret Mehmeti, Zëvendës Drejtor Rajonal në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Mitrovicë, foli për gjendjen e sigurisë së Rajonin e Mitrovicës, duke u përqendruar në strategjinë e Policisë së Kosovës, dhe këtu ai e përmendi edhe Komunën e Vushtrrisë. Ai foli për strategjinë e Komunave të këtij Rajoni, dhe e theksoi që në Komunën e Vushtrrisë janë dy Këshilla Komunale për Sigurinë në Bashkësi të cilat e japin kontributin e tyre në fushën e sigurisë.

Përqendrimi në Komunën e Vushtrrisë u bë edhe kur u fol për raportin e investimeve komunale në rini me nivelin e kriminalitetit. Këtu u theksua fakti i përmendur më heret që Komuna e Vushtrrisë e ka nivelin më të lartë të investimeve në rini nga të tri komunat e Rajonit, por, njëkohësisht, e ka edhe nivelin më të lartë të kriminalitetit.

Duke folur për këtë çështje, Nënkoloneli Nysret Mehmeti, Zëvendës Drejtor i Policisë Rajonale të Mitrovicës, e përmendi atë që Vushtrria e ka një gjendje më të mirë ekonomike se Mitrovica, dhe ky fakt është njëri ndër shkaktarët e nivelit më të lartë të kriminalitetit në Vushtrri. Ai e theksoi edhe atë që niveli i kriminalitetit në Vushtrri është rritur në dy vitet e fundit, meqë më parë niveli më i lartë i kriminalitetit ka qenë në Mitrovicë. Po ashtu, ai si faktor tjetër që ka mundur të ketë ndikim e përmendi edhe faktin që Komuna e Mitrovicës ka më pak fshatra, ndërkaq, ajo e Vushtrrisë më shumë, kështu që, meqë një pjesë e madhe e veprave penale ndodhin nëpër fshatra, kjo ka mundur të ndikojë në numrin e madh të tyre në Vushtrri.

Në fjalën e vet, Ymer Haradinaj, Asambleist i Kuvendit Komunal të Vushtrrisë po ashtu foli për faktin e mësipërm. Ai e përmendi atë që Vushtrria është një komunë me siguri më të ulët, dhe shtoi që njëri nga shkaqet për këtë është me siguri edhe gjeografia, dhe

numri i madh i fshatrave, duke shtuar që kjo Komunë i ka 66 fshatra dhe qytetin. Rrjedhimisht, numri i policëve në Komunën e Vushtrrisë, sado i madh që të mund të jetë, është në fakt i vogël për ta mbuluar një terren të tillë.

Asambleisti Haradinaj u përqendrua, mes tjerash, edhe në faktin e dhënë në Profilin e Rajonit të Mitrovicës, sipas të cilit në Komunën e Vushtrrisë nuk është mbajtur as edhe një seancë e vetme për ta trajtuar problemin e sigurisë. Ai theksoi që seanca të jashtëzakonshme, të fokusuara vetëm në çështjen e sigurisë vërtetë nuk ka patur, mirëpo, në seancat e rregullta, që janë për një numër më të madh të çështjeve, vijne edhe zyrtarë policorë, të cilët në mënyrë periodike raportojnë edhe për gjendjen e sigurisë.

Përndryshe, Zoti Haradinaj e lavdëroi bashkëpunimin që Kuvendi Komunal dhe popullata e ka me Policinë e Kosovës. Ai këtë bashkëpunim e ilustroi me veprimet e përbashkëta që janë bërë me Policinë për t'i eliminuar aksidentet me fatalitete që kanë ndodhur në fshatin e tij, Stanovc i Epërm, në auto-rrugën që kalon nëpër atë fshat. Ai e theksoi që në shtatorin e vitit të kaluar (2018) është mbajtur një mbledhje me Policinë e Kosovës për mobilizimin e qytetarëve që të mos bëhet dhe që të mos lejohet kapërcimi i pengesave për hyrje në auto-rrugë, i cili ka qenë shkaktari kryesor i atyre aksidenteve, dhe që qytetarët t'i shfrytëzojnë nën-kalimet. Që atëherë, sipas Asambleistit Haradinaj, nuk ka ndodhur asnjë aksident.

Zoti Haradinaj po ashtu u përqendrua edhe në numrin e madh të xhamive në Vushtrri, që ishte dhënë në Profil, dhe që u përmend gjatë Konferencës. Ai shpjegoi që ky numër i madh është pasojë e numrit të madh të fshatrave të Vushtrrisë, ku çdonjëri fshat e ka nga një xhami, ndërkaq, disa prej tyre i kanë edhe nga dy.

Përndryshe, Asambleisti Haradinaj shprehu kënaqësinë që sipas hulumtimit të Profilit Komuna e Vushtrrisë i ka investimet më të mëdha për rininë. Mirëpo, theksoi ai, pos

investimeve, duhet të bëhet edhe ngritja nëpër Kuvendet Komunale e shqetësimeve të rinisë. Ai tregoi që si arsimtar në Shkollën e Mesme Profesionale, e ka vërejtur që bisedat kryesore të nxënësve të klasave 11 dhe 12 janë si ta marrin një diplomë dhe ta sigurojnë ndonjë vizë për ndonjë shtet të jashtëm, dhe të ikin nga Kosova. Lidhur me këtë, Zoti Haradinaj u përqendrua edhe në zvogëlimin e popullatës, si në Komunën e Vushtrrisë, ku numri i banorëve nga 2011 deri më 2018 ka rënë nga 69.000 në 64.000, ashtu edhe në rajon. Përndryshe, kjo, sipas tij, vërehet edhe në pakësimin e numrit të nxënësve nëpër shkolla.

Për rastet e personave të kthyer nga luftrat në Lindjen e Mesme, ai tha që nuk di nëse organet komunale janë marrë me ta, por duhet të ntritët si shqetësim, dhe duhet bërë studime, për atë se cilët faktorë kanë ndikuar që ata të shkojnë, çfarë njerëzish kanë ndikuar në shkuarjen e tyre, si dhe për faktorët dhe shkaqet pse ata janë kthyer. Në fund Asambleisti Haradinaj po ashtu e ngriti edhe çështjen e mosvotimit të disave nga personave fetarë që nuk përkojnë me Islamin tradicional. Ai tha që gjatë bisedave me disa prej tyre, ata i kanë thënë që nuk dalin për të votuar, dhe e shtroi pyetjen se pse kjo është kështu.

Në këtë pyetje, organizatorët e Konferencës i dhanë shpjegimet për ndikimin e disave nga interpretimet juridike të Islamit që e parandalojnë votimin meqë nuk e pranojnë sistemin demokratik. Mirëpo, kjo pyetje shkaktoi reagimin e Nevzat Tahirit, anëtar i Kuvendit Komunal të Mitrovicës, i cili e vuri në pikëpyetje ndarjen e Islamit në Islamin e sotëm dhe në atë tradicional. Islami, siç tha ai, nuk është çështje e mjekrrës apo të veshjes. Në këtë organizatori i Konferencës bëri vërejtjen që Islami vërtetë është një, mirëpo, në kuadër të tij ka shkolla të ndryshme juridike, pra, ai është mjaft plural.

Lidhur me këtë çështje mendimin e vet e shprehu edhe Nexhmedin Spahiu, nga OJQ-ja Mitrovica. Ai theksin e vuri në dallimin midis lëvizjeve politike dhe doktrinafe fetare.

Veshja, siç e tha Zoti Spahiu, nuk është punë e fesë, por e një tradite. Te ne, shqiptarët, tradita kombëtare e ka plisin, dhe ne, herë pas here edhe në këtë kohë i kthehemi traditës dhe plisit. Dhe, edhe arabët e kanë të njëjtën gjë. Për shembull, tha Zoti Spahiu, kombi saudit i ka traditat e veta, dhe njerëzit tanë që shkollohen atje i përvetësojnë ato, meqë ata i financon shteti saudit, dhe ata dojnë që këto vlera të tyre të përvetësohen nga të tjerët. Problemi këtu, theksoi zoti Spahiu, nuk qëndron te shteti saudit, i cili don t'i përçojë ato vlera, por te ne, që nuk ndalemi në atë se çfarë dojmë të pranojmë, dhe çfarë jo.

Përndryshe, Zoti Spahiu u ndal edhe në disa shprehje në opinionin publik të frymës anti-islamiste, të cilat shpesh herë dijnë të jenë irrituese dhe ofenduese. Këto shprehje, theksoi Spahiu, nuk mund të kalojnë as në Suedi, ku shumica janë protestantë, ndërkaq myslimanët janë pakicë – po të flitej si te ne, atje do të reagohej. Pra, përfundoi Zoti Spahiu, kjo frymë anti-islamiste duhet të hiqet nga diskursi politik, përmes reagimit të institucioneve.

Rreth kësaj çështjeje të fundit që e ngriti Zoti Nexhmedin Spahiu, organizatori i Konferencës komentoi që në Kodin Penal të Kosovës është e ndaluar nxitja e urrejtjes fetare e kombëtare, por, fatkeqësisht, askush nuk merret me këtë punë. Problemi, pra, është mosndërmarrja e veprimeve që janë konform me Kodin Penal të Kosovës.

Komuna e Skenderajt

Siç u tha më sipër, në pjesën hyrëse të Konferencës foli Nënkolonel Nysret Mehmeti, Zëvendës Drejtor Rajonal në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Mitrovicë. Ai këtu foli për çështjet kryesore të sigurisë në Rajon, dhe për Komunën e Skenderajt e theksoi bashkëpunimin e Komunës së Skenderajt në çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë, duke theksuar që ky bashkëpunim zhvillohet përmes dy Këshllave Komunale për Siguri në Bashkësi.

Zotëri Pajazit Isufi, asambleist në Kuvendin Komunal të Skenderajt së pari u përqendrua në çështjet demografike, dhe në zvogëlimin e popullsisë së Rajonit të Mitrovicës, një çështje kjo që u përmend përciptazi si një brengë serioze (por nuk u diskutua më gjerësisht), nga më shumë folës në Konferencë. Zotëri Isufi e shprehu, edhe befasinë, edhe kënaqësinë, që Skenderaj është e vetmja nga tri komunat e diskutuara në Profil në të cilën ka patur rritje të popullsisë, edhe përkundrejt migrimit. Lidhur me problemin e migrimit ai tha që nga një mik i tij që ka agjenci të sigurimeve është informuar që në Skenderaj është një shifër alarmante e rreth 5,700 të rinjve që presin viza ose termine nëpër ambasadat e vendeve të huaja. Kjo, sipas tij, është një nga kërcënimet më të mëdha, si për Skenderajn, ashtu edhe për Kosovën.

Përndryshe, asambleisti Isufi e konfirmoi faktin e përmendur në Profil, që në Skenderaj nuk ka patur asnjë mbledhje për siguri, mirëpo, ai shtoi që kanë qenë disa takime ku ka qenë i ftuar edhe ai vetë, dhe këto çështje janë trajtuar nga disa organizata joqeveritare. Ai po ashtu theksoi që nga Komuna e Skenderajt, fatkeqësisht, ka patur pjesëmarrës në Luftën e Sirisë, dhe njëri prej tyre edhe është vrarë atje. Ky person ka qenë nga fshati Tushicë, dhe ky ka qenë nga një familje skajshmërisht e varfër. Pikërisht kjo Zoti Isufin e

bëri që ta shprehë habinë me faktin që në pamjen e organizuar për këtë person, vizitorët kanë qenë nga një shtresë mjaft e pasur, dhe se ka qenë mjaft e çuditshme të shohësh ata atutomobila aq të shtrenjtë në ceremoninë mortore në një familje aq të varfër.

Një temë tjetër në të cilën u përqendrua zoti Isufi ishte ajo e numrit krahasimisht të vogël të xhamive në Komunën e Skenderajt. Ai tha që në Skenderaj numri i xhamive është ndoshta më i vogël se në dy komunat e tjera, mirëpo ky numër është i mjaftueshëm. Këtu ai e përmendi edhe rastin e njëres xhami që është mbyllur në Komunën e Skenderajt, ku hoxha në atë xhami ka qenë nga Shqipëria, dhe theksoi që ajo xhami ka qenë tejet e dëmshme.

Përndryshe, asambleisti Isufi e bëri edhe një komentim ndaj fjalës së Nexhmedin Spahiut. Në seksionin për Komunën e Mitrovicës të këtij Raporti u theksua që Nexhmedin Spahiu, nga Komuna e Mitrovicës, duke u përpjekur që ta shpjegonte ndërlidhjen e investimeve në rini me nivelin e kriminalitetit në tri komunat e Rajonit të Mitrovicës, e kishte bërë krahasimin e numrit të viktimave në Shkodër dhe në Vlorë në trazirat e vitit 1997, dhe ndryshimin e tyre e kishte shpjeguar me faktin që në Shkodër funksionon Kanuni, ndërkaq në Vlorë jo. Ai me këtë ishte përpjekur që edhe dallimin e niveleve të kriminalitetit në komunat e Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Skenderajt ta shpjegonte me funksionimin e Kanunit. Lidhur me këtë, zoti Pajazit Isufi tha që niveli i ulët i kriminalitetit në Skenderaj nuk është pasojë e Kanunit, por më tepër fryt i bashkëpunimit të institucioneve shkollore dhe të atyre të sigurisë me qytetarët.

Në pjesën e fjalës së tij për përpjekjet që janë bërë që Lufta në Kosovë të bëhej fetare, të përmendur në seksionin e Komunës së Mitrovicës, Vesel Neziri, anëtar i Kuvendit Komunal të Mitrovicës nga Partia e Drejtësisë, theksoi që gjendja në Skenderaj është më e mirë, meqë Skenderaj i ka patur disa grante më të mëdha.

Në këtë, Vesel Neziri, anëtar i Kuvendit Komunal të Mitrovicës nga Partia e Drejtësisë, theksoi që në Skenderaj kanë ndikuar bizneset, dhe aty kanë qenë disa komandantë që i kanë ndalur këto gjëra. Ata, tha zoti Neziri, kanë miliona, dhe ne nuk kemi miliona. Më pas, ai këtë e krahasoi me Mitrovicën: dhe çfarë ndodh në Mitrovicë, pyeti ai. Gjithçka bëhet që qytetarët e Mitrovicës të mos e dojnë këtë vend, dhe që të ikin nga këtu, ashtu që kjo pjesë të shkojë me Serbinë.

Një pjesë tjetër e diskutimit për Komunën e Skenderajt u përqendrua në buxhetin e kësaj komune, dhe në mënyrën si ai grumbullohet dhe si shpenzohet. Zoti Pajazit Isufi, asambleist i Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajt, nga AKR-ja, duke reaguar në pohimin e Vesel Nezirit nga Komuna e Mitrovicës që gjendja në Skenderaj është më e mirë, meqë Skenderaj i ka patur disa grante më të mëdha, tha që Komuna e Skenderajt menaxhon me një buxhet prej 13 milionë e 700 mijë €, ku të hyrat vetjake të Komunës janë 7%. Kjo, sipas tij, përkon me 7% të buxhetit që është investim në kulturë. Krahasimisht, kjo sipas zoti Isufit është përafërsisht e njëjtë me Komunën e Vushtrrisë, që i ka 7.2%, dhe shumë më tepër se Mitrovica që ishte rreth 2%. Korniza afatmesme buxhetore e Komunës së Skenderajt, sipas tij, për këtë vit në katër shkolla ka paraparë ndërtimin e katër sallave të kulturës fizike, dhe në dy bashkësi lokale e ka paraparë renovimin e shtëpive të kulturës. Ai po ashtu vuri në dukje që nga 13.7 milionët, 3.8 milionë € janë paraparë për investime kapitale, ndërkaq, rreth 11 milionë për paga, shërbime dhe mallra.

Përndryshe, asambleisti Isufi e ceki edhe një vështirësi shtesë që e ka Komuna e Skenderajt sa i përket fondeve. Ai tha që Drejtoria e Kulturës në Komunë i menaxhon edhe përvjetorët dhe përkujtimet, të cilat, siç shpjegoi, në Komunën e Skenderajt fillojnë nga 5 marsi, dhe vazhdojnë deri më 16 qershor. Meqë në Skenderaj ka shumë

manifestime të tilla, kjo e absorbon një pjesë mjaft të madhe të shumës së përgjithshme, dhe kjo e paraqet një problem mjaft të madh në veprimtarinë e kësaj Drejtorie.

Consortium: "With Participatory Democracy for a Kosovo without Radicalization" | Konzorciumi: "Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizim"

